



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2114/3 Prot.

Laç, më 24.04.2023

VENDIM

Nr. 28 . Datë. 24.04.2023

**“PËR DHËNIE NË PËRDORIM ME KONTRATË QERAJE, TË SIPËRFAQES
PREJ 0.168 HA, NGA STRA 76/D, EKONOMIA PYJORE "MALBARDHË" PËR
VENDOSJEN E NJË STACIONI ANEMOMETRIK PËR QËLLIM STUDIMI,
SHOQËRISË “SURYA RENEËABLE ENERGY” SH.A.**

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1.2, germa "a", pika 1.6 germa "a", nenin 18 pika 1, neni 54, germa "e", neni 55, pika 4, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; të shtojcës nr.44 të VKM nr.684 dt.02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/ bashkive”, VKM nr.559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, në shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.7754 prot. datë 28.10.2021 “Kërkësë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës”, në shkresën e shoqërisë “Surya Reneëable Energy” sh.p.k nr.001 datë 10.03.2023 “Kërkësë për marjen me qera (shfrytëzim) për një periudhë kohore 1 vjeçare të hapësirës publike nën administrim të Bashkisë Kurbin, me qëllim vendosjen e një Stacioni Anemometrik, që shërben për matjen e Erës” administruar nga ana jone me nr.1497 Prot. datë 13.03.2023 si dhe në “Raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Kurbin shoqërisë ‘Surya Reneëable Energy’ sh.p.k” nr.1972/1 Prot. datë 14.04.2023, pas propozimit nga Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor, me kontratë qeraje, të sipërfaqes totale prej **0.168 ha**, për vendosje të Stacionit Anemometrik për qëllim studimi, nga shoqëria “Surya Reneëable Energy” sh.p.k, e cila pozicionohet në ngastrën nr.**76/d**, të Ekonomisë Pyjore “**Malbardhë**” në pronësi të Bashkisë Kurbin, me këto koordinata sipas sistemit koordinativ K.RR.GJ.SH:

Nr.	X	Y
1	4614112.789	479231.756
2	4614112.789	479271.756
3	4614154.789	479271.756
4	4614154.789	479231.756

2. Shoqëria paguan në llogarinë bankare të Bashkisë Kurbin, shumën prej **32 256 (tridhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë/vit** sipas "Raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Kurbin shoqërisë 'Surya Renewable Energy' Sh.A", i cili është pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Afati i dhënies në përdorim do të jetë **1 (një) vit**, me të drejtë rinovimi.

Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave).

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

> Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave).

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI


